

Informacion për tërheqjen e qumështit të adaptuar për foshnja Nestle të shpërndarë ndërkombëtarisht për shkak të kontaminimit me toksinën Cereulide

Më 08.01.2026 pranë Institutit të Shëndetit Publik të RMV-së arriti informacion për tërheqjen e një produkti ushqimor nga tregu i Maqedonisë së Veriut. Bëhet fjalë për disa lloje të qumështit të adaptuar për foshnja NAN, për shkak të pranisë së mundshme të toksinës cereulide të cilën e prodhon bakteri *Bacillus cereus*, në një nga përbërësit e furnizuesit që përdoret në seritë e mëposhtme:

Kodi Nestle	Emri i produktit	Seria - numri	Afati i skadencës:
12606122	NAN ExpPr HA BL DENWHB300 12x400g N2 RO	51280742C2	maj.27
12607942	NAN COMFORTIS1 NLNWPB109-2 6x800 N1 RO	51320346AE	maj.27
12607549	NAN OPTIPRO 1 NLNWPB261 6x800g N1 RO	51540346AB	jun.27
12607549	NAN OPTIPRO 1 NLNWPB261 6x800g N1 RO	52630346AB	Sep-27
12592158	NAN LACTOSE FREE NLNWB333 12x400g RO	53040346AE	okt.27
12607549	NAN OPTIPRO 1 NLNWPB261 6x800g N1 RO	51180346AD	apr.27

Sipas njoftimit, tërheqja preventive e produktit nga Nestle Adriatik Macedonia është bërë në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe në përputhje me protokollet e cilësisë dhe sigurisë së produktit.

Konsumatorët që mund të kenë blerë produkte nga seritë e lartpërmendura të produkteve të përmendura nuk duhet t'ua japin këtë produkt fëmijës së tyre dhe mund ta kthejnë atë për rimbursim te shitësi me pakicë ku edhe e kanë blerë. Nëse shfaqet ndonjë shqetësim si pasojë e konsumimit të këtij produkti, konsultohuni me pediatrin ose me ndonjë punonjës tjetër shëndetësor.

Prania e toksinës cereulide në ushqim shkakton nauze, të vjella, dhimbje barku, dobësi dhe këto simptoma zakonisht manifestohen nga 30 minuta deri në 6 orë pas konsumimit të ushqimit. Simptomat janë të ngjashme me ato të helmimit me toksinën stafilokoksike. Toksina është stabile në temperatura të larta dhe metodat e zakonshme të përgatitjes së ushqimit nuk e shkatërrojnë atë.

Sëmundja në përgjithësi është vetëlimituese brenda 24-48 orëve, por në situata të caktuara dhe te individët me imunitet të kompromentuar mund të shkaktojë komplikime.

Nëse keni dijeni për konsumin e këtyre produkteve dhe shfaqjen e simptomave gastrointestinale, ju lutemi kontaktoni mjekun tuaj amë ose pediatrin për ekzaminim dhe terapi të mundshme. Laboratori i mikrobiologjisë pranë ISHP të RMV-së disponon me reagensë për zbulimin e *Bacillus cereus*.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive

Instituti i Shëndetit Publik